



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I TIRANËS



AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Nr. 1356 Prot Tiranë, më 08.5.2023

Nr. 211 Prot Tiranë, më 08.5.2023

MARRËVESHJE

për

BASHKËPUNIM NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Ndërmjet

UNIVERSITETIT TË TIRANËS

dhe

AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Universiteti i Tiranës dhe Akademia e Studimeve Albanologjike:

Duke patur parasysh objektin e veprimtarisë institucionale të tyre;

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë, hulumtimit, kërkimit dhe studimeve me interes kombëtar;

Me dëshirën për të nxitur forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre për të ndihmuar në ruajtjen e gjuhës shqipe, historisë, kulturës dhe traditave kombëtare, etj;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e kësaj Marrëveshje për të përmbushur angazhimet në kuadër të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor dhe Kodit të Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, **lidhin këtë Marrëveshje bashkëpunimi me interes të përbashkët.**

Palët si vijon:

1. Universiteti i Tiranës, Përfaqësuar nga Prof. dr. Artan Hoxha, Rektor i Universitetit, me adresë: Sheshi Nënë Tereza, Tiranë,
2. Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, përfaqësuar nga Prof. dr. Luan Përzhita, Rektor i Akademisë, me adresë: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 3, Tiranë,

bien dakord si vijon:

Neni 1

Baza Ligjore

Të harmonizojnë bashkëpunimin e tyre institucional bazuar në Ligjin nr. 80/2015, "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Statutin, Rregulloren e Universitetit të Tiranës, Statutin dhe Rregulloren e Akademisë së Studimeve Albanologjike, strategjitë e zhvillimit të institucioneve

respektive, strategjitë kombëtare të zhvillimit të arsimit, shkencës në vendin tonë, si dhe në aktet nënligjore në fuqi në fushën e arsimit të lartë.

Neni 2

Qëllimi dhe objektivat

Nëpërmjet kësaj Marrëveshje bashkëpunimi, palët bien dakort dhe angazhohen që të bashkëpunojnë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në përputhje me strategjitë përkatëse të zhvillimit të institucioneve. Bashkëpunimi do të mbështetet mbi bazën e parimeve demokratike dhe në pajtim me autonominë universitare dhe lirinë akademike të të dy palëve.

Palët zotohen që të marrin në shqyrtim nevojat e vendit dhe ato të përbashkëta gjatë bashkëpunimit të tyre, me qëllim për të përfituar nga zhvillimi dhe shkëmbimi mësimor dhe shkencor, aktiviteteve trajnuese/ edukuese të personelit akademik dhe projekteve të përbashkëta të zhvillimit, studimeve në fushën e gjuhësisë e letërsisë, albanologjisë, arkeologjisë, antropologjisë etj.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë

Palët bien dakord të rrisin bashkëpunimin në këto drejtime kryesore:

1. Bashkëpunim në fushat e kërkimit shkencor në përputhje me fushën e veprimtarisë që aktualisht zhvillojnë institucionet.
2. Bashkërendimin e politikave të hulumtimeve, kërkimeve, studimeve mbështetëse, në fusha të reja të zhvillimit si shkencat albanologjike, gjuhësia, letërsia, historia, arkeologjia etj.
3. Zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe kërkimit shkencor.
4. Shkëmbim të personelit akademik për veprimtaritë akademike, kërkimore-shkencore, praktikave profesionale, dhe trajnimeve të përbashkëta.
5. Mobilitetin e personelit akademik, kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarive kërkimore shkencore në shkencat albanologjike.

6. Hartimin dhe mbështetjen reciproke, realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese, në fushat e sipërcituara.
7. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e publikimeve) në fusha me interes të dyanshëm.
8. Vënien në dispozicion të infrastrukturës respektive, në funksion të veprimtarive akademike e shkencore, shkëmbimin e literaturës shkencore që palët disponojnë, aksesin në arkivë, bibliotekë, laboratorë etj.
9. Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional dhe aspekte të tjera të karakterit administrativ.

Neni 4

Angazhimi i palëve

Të dy institucionet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Për detajimin e bashkëpunimit në fushat e mësipërme dhe ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes, Palët caktojnë nga një koordinator.

Komisioni i përbashkët, harton dhe propozon planin e detajuar të veprimtarive dhe aktiviteteve të përbashkëta, për 5 vitet në vijim, duke përfshirë kostot financiare, logjistike dhe aspekte të tjera të nevojshme, për realizimin e tij, në përputhje me këtë Marrëveshje. Plani i aktiviteteve, bëhet pjesë e kësaj Marrëveshje.

Neni 5

Detyrimet e Palëve

Angazhimet e palëve në këtë Marrëveshje, respektohen pa cenuar veprimtaritë, aktivitetet dhe çdo angazhim individual, apo me palë të treta të institucioneve.

Nënshkrimi i kësaj Marrëveshje nuk nënkupton implikim të palëve në detyrimet ndaj palëve të tjera, apo përfitime nga aktivitetet individuale, përveç rasteve kur ato parashikohen dhe miratohen.

Neni 6

Klauzola e pjeshme

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshje ose pjesë të saj, duhet të bëhen të pavlefshme ose të pazbatueshme, për çfarëdolloj arsyeje, ajo dispozitë apo pjesë e saj, në rastet kur është e arsyeshme dhe pa cenuar dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje, do të zëvendësohet me një dispozitë të arsyeshme që duhet të dakordësohet me shkrim nga palët.

Neni 7

Amendimet në Marrëveshje

Amendimi ose ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje do të hyjë në fuqi vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e të dy palëve kontraktuese.

Në rast se palët bien dakord për rishikime në përmbajtje, afatin kohor, ndryshime të tjera, një shtojcë që pasqyron këto ndryshime do të bëhet pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Konfidencialiteti

Palët e kësaj Marrëveshjeje, do të ruajnë në çdo kohë të dhënat konfidenciale që mblidhen si pasojë e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të informacionit, për të cilin ata mund të autorizohen ose lidhen ligjërisht, për ta dhënë si detyrim ligjor, apo kur kërkohet nga agjencitë rregullatorë, ose për konsulentët e tyre profesionalë.

Neni 9

Transparenca dhe Njoftimet

Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, të dyja palët marrin përsipër që zyrtarisht ose punonjësit e tyre të informojnë njëra – tjetrën mbi aktivitete, vendimmarrje të cilat kanë impakt në fushën e veprimtarisë së përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Çdo njoftim i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet zyrtarisht me shkrim.

Neni 10

Kohëzgjatja e bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy institucionet janë dakord për këtë. Mosrinovimi i kësaj Marrëveshjeje, bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Për

Universitetin e Tiranës

REKTORI

Prof. Dr. Artan Hoxha



Për

Akademinë e Studimeve Albanologjike

REKTORI

Prof. dr. Luan Përzhita

